

**Vendim nr.194, datë 11.06.2026**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

|                   |          |
|-------------------|----------|
| Fiona Papajorgji, | Kryetare |
| Asim Vokshi,      | Anëtar   |
| Marjana Semini,   | Anëtare  |

në datën 11.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (H) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUESE:** **HAJRIE ASLLANI, NURE VATA (ASLLANI),**  
përfaqësuar nga avokati Besim Peka, me prokurë.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-4498, datë 17.12.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 4, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, dhe pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Kërkueset janë trashëgimtare ligjore (bashkëshortja dhe e bija) të shtetasit të ndjerë L.A., i cili ka pasur një konflikt pronësie me shtetasin N.H., për dy sipërfaqe trualli 628 m<sup>2</sup> dhe 756 m<sup>2</sup> secila, për të cilat ky i fundit ka pretenduar se janë pjesë integrale e tokës së përfutur me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (*AMTP*) të datës 10.05.1996, në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” (*ligji nr.7501/1991*), të ndryshuar.

2. Në këto kushte shtetasi N.H. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lirim dhe dorëzimin e truallit të pretenduar të zënë e të poseduar në mënyrë të paligjshme nga shtetasi L.A., dhe me vendimin nr.1884, datë 10.02.2014, ajo gjykatë ka vendosur detyrimin e trashëgimlënësit të kërkueseve të lirojë dhe dorëzojë sipërfaqet e zëna në mënyrë të paligjshme dhe pa titull pronësie. Me vendimin nr. 586, datë 05.03.2015, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

3. Në datën 15.04.2015 trashëgimlënësi i kërkueseve i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi kundër shtetasit N.H. dhe bashkëshortes së tij, me objekt: (i) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të AMTP-së në emër të shtetasit N.H. për një tokë të llojit “arë”, me sipërfaqe 4300 m<sup>2</sup>, të regjistruar në regjistrin hipotekar dhe (ii) detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Tiranë të bëjë çregjistrimin e saj dhe kalimin në favor të shtetit.

4. Në vijim, me shkresën e datës 12.05.2015, Bashkia Kamëz ka bërë më dije gjykatën e shkallës së parë se pas verifikimeve të kryera pranë zyrës së menaxhimit të territorit, planifikimit dhe monitorimit, Bashkia Kamëz, trashëgimlënësi i kërkueseve L.A. nuk rezulton të jetë trajtuar me tokë “arë” në bazë të ligjit nr. 7501/1991, të ndryshuar.

5. Me shkresën e datës 06.11.2015, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Arkivit Qendror, ka bërë me dije gjykatën e shkallës së parë se, në cilësinë e punëtorëve të ish-Ndërmarrjes Bujqësore Kamëz, të paditurit kanë përfutur tokë bujqësore në zbatim të ligjit nr. 7501/1991, të

ndryshuar, të regjistruar në zbatim të ligjit nr. 7843 datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, sikurse faktohet me vërtetimin e lëshuar nga ZVRPP-ja, Tiranë.

6. Gjatë gjykimit në shkallë të parë është provuar me vendime të gjykatave të faktit të paraqitura në cilësinë e provës, se një pjesë të truallit në pronësi të të paditurve, është zënë nga ndërtimi pa leje i trashëgimlënësit të kërkueseve, i cili ndodhet në proces legalizimi. Me vendimin nr. 5796, datë 16.11.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë së trashëgimlënësit të kërkueseve, me arsyetimin se, bazuar në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë të tokës bujqësore”, trashëgimlënësi i kërkueseve në cilësinë e paditësit nuk ka paraqitur asnjë kërkesë në Sekretariatën Teknik të Komisionit Qeveritar të Tokës për vlefshmërinë e AMTP-së mbi tokën bujqësore dhe nga ky i fundit nuk ka rezultuar të ketë një vendimmarrje në këtë drejtim, sikurse është vërtetuar me shkresën e datës 06.04.2015 të këtij institucioni. Gjithashtu, sipas asaj gjykate, pretendimi i paditësit se është në procedurë legalizimi nuk e legjitimon atë në ngritjen e padisë, pasi konflikti gjyqësor është ezauruar me vendim gjyqësor të formës së prerë nr. 1884, datë 10.02.2014 të gjykatës së shkallës së parë, lënë në fuqi me vendimin nr. 586, datë 05.03.2015 të gjykatës së apelit, për të cilin është lëshuar urdhër ekzekutimi. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, paditësi nuk legjitimohet t’i drejtohet gjykatës në ngritjen e padisë, pasi, nga ana e tij, nuk është provuar interesi i ligjshëm i cenuar. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim trashëgimlënësi i kërkueseve (*paditësi*).

7. Me vendimin nr. 296, datë 31.01.2018, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, duke arsyetuar në të njëjtën linjë me të, si dhe duke arritur në përfundimin se paditësi nuk legjitimohet t’i drejtohet gjykatës në ngritjen e padisë, pasi nga ana e tij nuk rezulton i provuar interesi i ligjshëm i cenuar. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs trashëgimlënësi i kërkueseve, i cili ka pretenduar se konstatimi i pavlefshmërisë absolute të AMTP-së së palës së paditur i jep mundësinë atij që nëpërmjet Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale të fitojë me kundërshpërblim pronësinë e truallit objekt të legalizimit.

8. Me vendimin nr. 00-2025-4498, datë 17.12.2025, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë argument të

qenësishëm që të lidhej me një nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

9. Në datën 08.04.2026 kërkuueset i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 16.04.2026.

## II

### Pretendimet e kërkuueseve

10. **Kërkuueset**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar:

10.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

10.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata e Lartë ka bërë një interpretim formalist dhe tepër të kufizuar të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012. Trashëgimlënësi i kërkuueseve ka ndërtuar një shtëpi banimi mbi tokën për të cilën është kërkuar pavlefshmëria absolute e AMTP-së të dhënë në kundërshtim me ligjin, ndaj ka të drejtën për të marrë një përgjigje nga gjykatat.

10.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka analizuar pretendimet për pavlefshmëri absolute, të cilat përbëjnë çështje të rëndësishme themelore për njësimin e praktikës në drejtim të legjitimitetit aktiv të palës paditëse në rastet e AMTP-ve.

10.2. *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi kërkuueset janë ende në proces legalizimi, që i njeh të drejtën për të fituar pronësinë me kundërshtpërblim dhe refuzimi për të shqyrtuar pavlefshmërinë absolute të AMTP-së i vendos ato në një situatë juridike të pasigurt.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitetin e kërkuueseve*

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik,

subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

12. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se trashëgimlënësi i kërkueseve ka kundërshtuar procesin gjyqësor administrativ lidhur me pavlefshmërinë e titullit të pronësisë në të gjitha shkallët e tij. Për rrjedhojë, nga aspekti *procedural* kërkuëset e justifikojnë interesin e tyre në çështjen e parashtruar, pasi trashëgimlënësi i tyre ka qenë palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar.

13. Për sa i përket *aspektit substancial* të legjitimitimit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës.

14. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor i përmbyllur me vendimin e Gjykatës së Lartë, objekt i ankimit kushtetues, ka të bëjë, në thelb, me kundërshtimin e titullit të pronësisë (AMTP), për të cilin është lëshuar certifikatë pronësie në emër të palës së paditur, kundërshtare me kërkuësin në procesin gjyqësor, si dhe me detyrimin e ZVRPP-së, Tiranë për çregjistrimin e kësaj prone dhe kalimin në favor të shtetit. Këto pretendime të trashëgimlënësit të

kërkuesve janë rrëzuar nga gjykatat e faktit me arsyetimin se ai nuk legjitimohet t'i drejtohet gjykatës në ngritjen e padisë, pasi nuk ka provuar se është cenuar në interesat e tij të ligjshëm, për sa kohë titulli i pronësisë nuk është kundërshtuar fillimisht në rrugë administrative, si dhe konflikti gjyqësor midis palëve ka përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për të cilin është lëshuar urdhër ekzekutimi për lirimin dhe dorëzimin e truallit të zënë. Ky përfundim është konsideruar i drejtë nga Gjykata e Lartë, e cila nuk ka pranuar rekursin e kërkuesit.

15. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kundërshtimi i procesit gjyqësor të përmbyllur me vendimin e Gjykatës së Lartë, objekt i ankimit kushtetues, nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e kërkueseve në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi gjyqësor i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore të tyre, për sa kohë kërkueset, në cilësinë e subjektit në proces legalizimi, nuk kanë arritur të provojnë sesi pronësia e tokës dhe fakti se cili është ose do të jetë pronari i saj, do të prodhojnë pasoja mbi to. Pronësia e tokës nuk ka rëndësi për procesin e legalizimit, ndaj fati i këtij procesi nuk u sjell dëm kërkueseve. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkueset nuk legjitimohen *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Si përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.